

Programi për Hulumtime dhe Publikime

16. Programi për Hulumtime dhe Publikime

Në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe kategorive tjera të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, krahas aspektit të trajnimit gjyqësor kontribon edhe hulumtimi, analiza dhe veprimtaria botuese në fushën ligjore. Kjo komponentë zbatohet përmes Programit për Hulumtime dhe Publikime dhe fokusi i saj në vazhdimësi është ofrimi i qasjes në burimet ligjore përmes bibliotekës së Akademisë, krijimit të burimeve tjera dhe veglave të reja për punë me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori.

Qëllimi i PHP-së është:

- Realizimi i hulumtimeve për zhvillimin e programeve trajnuese të AD-së;
- Sigurimi dhe ofrimi i burimeve ligjore të nevojshme për përfituesit e vet;
- Shfrytëzimi i resurseve ligjore për nevojat e gjyqësorit;
- Përmirësimi i cilësisë së botimeve dhe publikimeve shkencore;
- Inkurajimi dhe përfshirja e komunitetit ligjor veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve në publikime shkencore.

16.1 Analiza dhe hulumtime

Analizat dhe hulumtimet gjatë vitit 2020 do të jenë të përkushtuara në drejtim të zhvillimit të programeve trajnuese në përputhje me standardet evropiane si dhe për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në dobi të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve trajnuese do të realizohet:

- Analiza në vazhdimësinë e formularëve të vlerësimit pas secilit sesion trajnues gjatë vitit 2020 duke përfshirë edhe vlerësimin e performancës së trajnuesve dhe metodologjisë së trajnimit;
- Analiza e pjesëmarrjes në trajnime të përfituesve të programeve trajnuese;
- Analiza e dokumenteve strategjike dhe raporteve të ndryshme të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare që merren me monitorimin e sistemit të drejtësisë veçanërisht kur ka të bëjë me kapacitetet profesionale në gjyqësor;
- Vlerësimi i nevojave trajnuese i cili do të përfshijë të gjithë akterët e sistemit të drejtësisë duke përfshirë edhe pyetësorët në gjykata dhe prokurori që do të ketë në fokus profilin, metodologjinë e trajnimit, përmbajtjen dhe çështjet organizative;
- Hulumtime rreth problemeve praktike të cilat mund të adresohen qoftë përmes trajnimeve ashtu edhe përmes krijimit dhe zhvillimit të burimeve të ndryshme juridike;
- Hulumtime sipas nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit.

16.2 Veprimtaria botuese – publikimet

Zhvillimi profesional i gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë arrihet edhe përmes publikimeve në fushën juridike me theks të veçantë në punën e gjyqësorit. Kjo komponentë pasuron kulturën juridike me njohuri praktike dhe teorike dhe synon të jetë në hap me ndryshimet legjislative në vend përmes revistave, doracakëve, udhëzuesve dhe formave tjera të botimeve.

Në publikimet e Akademisë do të angazhohen ekspertë të fushave të ndryshme të së drejtës për të dhënë ekspertizën e tyre qoftë në revista, module trajnuese dhe materiale tjera ligjore përmes të cilave do të ndikohet në pasurimin e kulturës juridike me njohuri praktike dhe teorike.

Publikimet e Akademisë synojnë që të jenë burim informimi veçanërisht me praktikën gjyqësore dhe risitë në legjislacion dhe në përgjithësi në lëmin e drejtësisë si dhe informues për aktivitetet trajnuese të Akademisë.

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2020 do të funksionalizoj nxjerrjen e revistës “Opinio Juris” e cila ishte ndërprerë deri me hartimin e standardeve të botimit dhe konsolidimin e trupës së re të Këshillit të Redaksisë. Kjo revistë do të vazhdojë të nxisë komunitetin ligjor në publikimin e rezultateve hulumtuese. Ngjashëm do të veprohet edhe me revistën “Justicia” e cila përmbledhë punimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar të cilët vijojnë trajnimet në Programin e Trajnimit Fillestar si dhe module të ndryshme të trajnimit fillestar, trajnimeve të vazhdueshme, trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, programe pune si dhe raporte tjera informative.

Në kuadrin e publikimeve, Akademia do të fokusohet në botime që kryesisht do i referohen ndryshimeve legjislative.

16.3 Biblioteka

Në vazhden e aktiviteteve të bibliotekës primare do të jenë sigurimi dhe ofrimi i burime ligjore për gjyqtarët, prokurorët e shtetit dhe profesionistët e tjerë ligjor. Këto resurse do të jenë edhe në shërbim të nevojave të trajnuesve dhe stafit të AD-së.

Në funksion të menaxhimit dhe pasurimit të koleksioneve të saj do të vazhdohet me:

- Katalogimin dhe klasifikimin e materialeve të reja ligjore;
- Skanimin e librave fizik dhe publikimin e tyre në bibliotekën elektronike për të dhënë informacion më të detajuar për përmbajtjen e tyre;
- Ofrimit të qasjes në disa data baza të ndryshme ligjore përmes vazhimit të anëtarësimit në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike;
- Ofrimin e materialeve të reja ligjore për përfituesit e Akademisë.